



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT  
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
PROCUREMENT REVIEW BODY

REPUBLICA E KOSOVËS / REPUBLIK  
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE  
Dati/Datum. 08.01.19  
PRISHTINË - PRISTINA

694/18

PSH.nr.694/18

PANELI SHQYRTUES,i emëruar nga Kryetari i OSHP-së, në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042,i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje z.Nuhi Paçarizi -Kryetar, z.Blerim Dina - Referues, z. Goran Milenković - Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatoriekonomik:NNT "Eing Com" - Podujevë, kundër njoftimit për anulimin e aktivitetit të prokurimit me titull:"Furnizim i shportave të xhepit dhe ulseve", me numër të prokurimit: 616-18-5173-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Prishtinë,më datë:27.12.2018, mori këtë:

V E N D I M

I.APROVOHET,siebazuar ankesa e operatorit ekonomik:NNT "Eing Com" - Podujevë,lidhur me aktivitetin e prokurimitme titull:"Furnizim i shportave të xhepit dhe ulseve", me numër të prokurimit: 616-18-5173-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK – Prishtinë.

II. ANULOHET,njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull:"Furnizim i shportave të xhepit dhe ulseve", me numër të prokurimit: 616-18-5173-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Prishtinë, dhe lënda kthehet nëRi-vlerësim.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV.Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues: NNT "Eing Com" - Podujevë, aprovohet si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

**VI.** Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

## **ARSYETIM**

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:13.07.2018.

Hapja e ofertave është bërë me dt: 09.08.2018, ku kanë marrë pjesëdy(2) operator ekonomik.

Letra standarde për Operatorin Ekonomik:NNT "Eing Com" - Podujevë, si tenderues i eliminuar nga Autoriteti Kontraktues, është dërguar me dt:14.11.2018.

Kundër njoftimit për anulim të aktivitetit operatori ekonomik, me dt: 16.11.2018, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.

Me dt: 19.11.2018, Autoriteti kontraktues ka marr vendim dhe refuzon kërkesën për rishqyrtim të operatorit ekonomik:NNT "Eing Com" - Podujevë,si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues:NNT "Eing Com" - Podujevë, si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me 29 Nëntor 2018, me nr.694/18,kundër njoftimit për anulimit të aktivitetit të prokurimit me titull:"Furnizim i shportave të xhepit dhe ulseve", me numër të prokurimit: 616-18-5173-121, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – KK - Prishtinë, duke pretenduar se:

- Autoriteti kontraktues ka vepruar në kundërshtim me nenet: 7,59, 65,të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 28, 41, të RROUPP-së.

Organi Shqyrtares i Prokurimit, konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 06.12.2018,ka autorizuar ekspertinshqyrtues-profesional, për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.Ekspertishqyrtues në raportin e dt: 19.11.2018, sqaron:

OE ankuese "N.N."EING COM" -Podujevë , pretendon se AK-Komuna e Prishtinës nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së, Ky nen është shkelur pasi qe AK-ja nuk i ka vlerësuar te gjithë OE njësojsipas OE

ankues.

Ekspertja shqyrtues konstaton se nenit 7 i LPP-sështë shkelur nga AK, pasi që AK ka vlerësuar në mënyrëjo të drejtë ofertën e OE Ankues sepse i njëjti i ka plotësuar te gjitha kriteret e te parapara ne njoftimin për kontrate dhe me dosjen e tenderit dheështë OE. me çmim më të lirë, është shpallur OE i eliminuar, duke u vlerësuare jo plotësisht siqë parashihet me nenin 59 të LPP-së. AK nuk e ka prezantuar asnjë dëshmi se Operatori Ankues ka ofertuar me çmim 10 fish ma të lart në njërin pozicion dhe me çmim abnormalisht te ulët në pozicionin tjetër por vetëm e ka përmendur çmimin e tregut, që nuk është e mjaftueshme dhe bindes për të ia falur besimin dhe mohuar pretendimin e OE ankues i cili pretendon se gjatë vlerësimit ka pasur tendencë të mos i jepet kontrata duke mos e trajtuar në mënyrë të barabartë konform nenit 7 të LPP Barazia në trajtim jo diskriminim.

OE ankues pretendon se është shkelur nenit 59 i LPP-së Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe nenit 41 i Rregullave dhe UOPP-së Ekzaminimi vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve. Ekspertja shqyrtues konstaton se ky pretendim ështëi bazuar, Sepse nuk është bërë vlerësimi sipas LPP sepse .

*Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime lidhur me pozicionin 2 bazës së shportës dhe njëkohësisht ju ka sqaruar se keni ofruar çmim shumë të lart dhe sipas te gjitha analizave te tregut çmimi i ofruar është 10 fish ma i lart se çmimi i tregut dhe njëkohësisht ka konstatuar se atë çmim e keni dhenë me qellim që çmimi i poentuar të jetë në favorin tuaj .*

*Ne sqarimin tuaj keni deklaruar se shpërndarja e çmimeve është çështje e kompanisë por në ketë rast nuk i keni marr për bazë faktet ne vijim:*

*Përqindjet e dhëna për pozicion në dosje janë analizuar paraprakisht dhe paraqesin raport real dhe janë obligative dhe*

*Është e drejtë e AK-së që të kërkojë sqarime për te gjitha paqartësitë në tenderë dhe kur këto kërkohen nuk janë më çështje e kompanisë por janë obligative që për ju që sqarimet e kërkua e dorëzonin.*

Sqarimi i ofruar nga OE. është konformkërkësës së AK-së dhe është çështje e kompanisë që ti vendos çmimet neper pozicione, Konstatimi i komisionit te vlerësimit se çmimi i ofruar nga OE ankues është 10 fish ma i lart se çmimi i tregut është i pabazuar sepse ne dokumentet e ofruara nuk ka asnjë dëshmi te prezantuar se AK ka bërë hulumtimin e tregut –nuk ka marr asnjë ofertë të tregut e cila dëshmon hulumtimin e tregut dhe njëkohësisht nuk ka as ndonjë dëshmi se AK ka bërë hulumtim te çmimit nga interneti e cila do të bindë Operatorin ekonomik dhe neve se OE ka ofruar çmime që dëmtojnë buxhetin e

AK-së apo edhe çmime abnormalisht të ulëta siç janë dhenë në përgjigjeje e dhenë me vendimin e datës 19.11.2018 nga zyrtari përgjegjës i prokurimit.

Konstatimi i komisionit vlerësues se çmimi i dhënë është bërë me qellim të poentimit është supozim sepse AK. me rastin e përpilimit te dosjes së tenderit i ka dhënë vetëm 7% rëndësi këtij pozicioni dhe nuk është e cekur sasia e përafërt për asnjërin pozicion ,që len të kuptohet se Autoriteti kontraktues nuk ka analizuar mirë ofertën e OE ankues sepse nëse e njëjtë do të analizohet sipas përqindjes do te thotë se AK. Kapranuar ofertë të favorshme sepse pozicioni për te cilin pretendon AK se ka ofertuar me çmim të lart është i peshuar vetëm me 7%.Ndërsa për pozicionin e par i cili është i peshuar me 93% AK. Gjegjësisht zyrtari përgjegjës i prokurimit ka deklaruar ne përgjigjeje e datës 19/11.2018 se OE ankues ka ofruar çmim abnormalisht te ulët prandaj vet përgjigjeje e dhënë me vendim dhe konstatimi i dhëne me rastin e anulimit janë ne kundërshtim me njëratjetrën.AK-së nuk ka vërtetuar çmimet që pretendon se janë abnormalisht të ulëta dhe çmimet që pretendon se janë te larta.

OE pretendon se është shkelur nen 62 i LPP Përfundimi i Aktivitetit të prokurimit. Ekspertja shqyrtyuese konstaton se ky pretendim ankimore është i bazuar sepse AK me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit nuk ka dhënë asnjëren nga arsyet e parapara ne nenin 62 te LPP-së siç janë:Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënen e kontratës vetëm për njëren nga arsyet:një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amendamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.Të gjithë tenderët e përgjegjshëm përbajnë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo Anulimi i aktivitetit të prokurimit pa u ndërlidh me njëren nga këto arsyet është i pabazuar.

OE pretendon se është shkelur nen 69 Lidhur me Aftesin teknike dhe Profesionale,Ekspertja e prokurimit konstaton se ky pretendim është i pa bazuar sepse AK nuk e ka eliminuar nga gara dhe nuk e ka anuluar aktivitetin e prokurimit lidhur me aftesinë teknike ose Profesionale siç parashihen në nenin 69 të LPP-së

OE pretendon se është shkelur nen 28 Rregullave dhe UOPP-së -Kriteret e dhënies së kontratës.

Ekspertja shqyrtyuese konstaton se ky pretendim ankimore është i bazuar sepse AK me të drejtë e ka vlerësuar ofertën e OE. ankues dhe nuk e ka mohuar faktin se operatori

ekonomik ankues do dilte fitues sikur mos të anulohet aktiviteti i prokurimit .

OSHP-ja paneli shqyrtues ka rekomanduar autoritetit kontraktues te ketë parasysh nenin 6 dhe 1 te LPP-së duke theksuar se AK është i obliguar ta ketë në konsideratë nenin 6 dhe 1 të LPP-se te cilët për qellim kanë ruajtjen e buxhetit.

Ekspertja shqyrtuese konstaton se ky rekomandim nuk ështërespektuale plotësisht nga AK me rastin e rivlerësimit sepse me rastin e rivlerësimit nuk i kanë jep rëndësi pozicionit te par që vet e kanëpoentuar me 93% dhe kanë zyrtari përgjegjës i prokurimit ka konstatuar se OE ankues ka ofertuar me çmim tepër te lirë por ma tepër ju kanë dhënë rëndësi pozicionit apo nivelit te dytë qe fillimisht e kane poentuar me 7% andaj mendoj se nuk ështërespektuarplotësisht vendimi i OSHP-së.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, ekspertja shqyrtuese i propozon panelit shqyrtues që ankesën e Operatorit Ekonomik „NNT EingCom”ta aprovoj dhe të anulohet njoftimi për anulimin e aktivitetit dhe rekomandon që lënda të kthehet në Rivlerësim.

Operatori ekonomik ankues:NNT "Eing Com" - Podujevë, me datë: 21.12.2018, me anë të parashtresës, ka njoftuar OSHP-në, sepajtohet me mendimin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës: 27.12.2018, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, përfaqësuesi i OE ankues, eksperti shqyrtues-profesional i OSHP-së,u shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për konratë, procesverbali mbi hapjen e ofertave, vendimi mbi themelimin e komisionit të vlerësimit të ofertave, raporti i vlerësimit të ofertave, njoftimi për anulimin e aktivitetit të prokurimit, anesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertizës të OSHP-së, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE ankues z. Podgorica deklaroj: Ne jemi pajtuar me mendimin e ekspertit deshtë te shtoj qe kjo lëndeështëpërherën e dyte ne OSHP dhe AK kontraktues pasi qe është urdhëruar qe ta kthej lenden ne rivlerësim nga paneli shqyrtues AK përsëri e anulon këtë aktivitet te Prokurimit thuajse për arsyte te njëjtë.

Përfaqësuesi i AK-znj Jashari deklaroj: AK mbështet aktivitetin e anulimit

Gjatë prezantimit në seance Eksperti profesional znj. Krasniqi deklaroj: Pas shqyrtimit te lendet dhe te gjithëkriteret e parapara ne dosje te tenderit dhe ne njoftim për kontrate dhe te gjithë dokumenteve te dorëzuara nga OE, gjate hartimit te ekspertizës jam bindur qe AK nuk e ka vlerësuar konform LPK-se konform rregullave te prokurimit aktivitetin e prokurimit dhe pa u siguruar njërin nga kushtet e parapara ne nenin 62 te LPK-se ka nxjerre vendim ne te cilin e anulon aktivitetin e prokurimit. Unë ne cilësinë e ekspertes konstatoj qe pretendimet e OE ankues janë te bazuara dhe mbes ne tërësipër konstatimet e dhëna ne ekspertize.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional, deklarimit te palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, konstaton se gjatë rivlerësimit te këtij aktiviteti te prokurimit nga AK-ja nuk është respektuar ne tërësi, vendimi i Panelit shqyrtues për këtë aktivitet te prokurimit, si dhe ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me paragrafët e nenit 62 të LPP-së, dhe nenet 44.7 dhe 44.8 të RrUOPP-së. Andaj me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues është i obliguar që të respektoj dispozitat e LPP-së si dhe vendimin e OSHP-së të cekur si më lart, për faktin se vendimet e OSHP-së janë te obligueshme që të respektohen nga palët dhe se kundër tyre palët e pa kënaqura mund ti drejtohen gjykatës kompetente me kërkësepadi.

Paneli shqyrtues konstaton se anulimi i aktivitetit të prokurimit nuk është bërë në përputhje me nenin 62 të LPP-së Citat:

1. Autoriteti kontraktues duhet të përfundojë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëren nga arsyet:

1.1. një shkelje e ligjit aktual ka ndodhur apo do të ndodh në procedurën e prokurimit, e cila nuk mund të rregullohet apo të parandalohet përmes një amandamenti ligjor të kushteve të prokurimit, duke përfshirë edhe rastet ku një dispozitë e këtij ligji kërkon anulimin e aktivitetit të prokurimit.

2. Autoritetet kontraktuese mund të përfundojnë atë aktivitet të prokurimit i cili nuk do të rezultojë në dhënien e kontratës vetëm për njëren nga arsyet:

2.1. të gjithë tenderët e përgjegjshëm përbajnjë çmime që e tejkalojnë buxhetin e autoritetit kontraktues për aktivitetin e prokurimit; apo

2.2. para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet

të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve.

Paneli shqyrtues konstaton se ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave nuk është bërë konform nenit 59 dhe 60 të LPP-së. Paneli shqyrtues duke u bazuar ne ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit obligon AK KK Prishtinë, që gjatë rivlerësim të ofertave të bënë vlerësim real të ofertave sipas kërkesave te vendosura nga vet AK ne njoftimin për kontrate dhe në dosje të tenderit.

Paneli shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues duhet te ketë në konsideratë nenin 1 të LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Po ashtu autoritetet kontraktuese duhet vepruar në harmoni me nenin 6 të LPP-së, ku autoritetet kontraktuese janë të obliguara qëtësigurojnëqë fondepublikedhe burimetpubliketëpërdorennëmënyrënmëekonomike,njëkohësishtdukemarrë nëkonsideratë qëllimin dhelëndëne prokurimit ashtu siç parashihet në nenin 6 të LPP-së. Gjithashtu autoriteti kontraktues duhet vepruar në pajtim me nenin 7, 59 dhe 60 te LPP-së si dhe nëse është e nevojshme për informata dhe sqarime shtese edhe konform nenit 72 te LPP-së.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapositiv të këtij vendimi.

#### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit .



#### Vendimi t'i dorëzohet:

- 1x1 AK -KK - Prishtinë
- 1x1 OE -NNT "Eing Com" - Podujevë
- 1x1 Arkivës së OSHP-së;
- 1x1 Për publikim nëweb- faqe të OSHP-së.